



Prishtinë, 09 shkurt 2010

Kodi i ZRRE-së: V_225_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

- Nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-080
- Nenin 22 të Ligjit për Energji Elektrike
- Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2009 (UA), të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave (MEM), të nxjerr me 17 gusht 2009, mbi Kushtet për Përcaktimin e Konsumatorit të Privilegjuar,
- Njoftimin Publik të publikuar nga ZRrE me datë 29 janar 2009,
- Kërkesën për marrje të statusit të konsumatorit të privilegjuar të kompanisë “Birra Peja” Sh.a me adresë Rruga “Nexhdet Basha” nr. 160, 30000 Pejë, Kosovë, të datës 01.10.2009,

në mbledhjen e mbajtur më 09 shkurt 2010 nxori këtë :

VENDIM

I jepet Statusi i Konsumatorit të Privilegjuar kompanisë “Birra Peja” sh.a.

Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) me datë 01.10.2009 nga kompania “Birra Peja” **sh.a.**, ka pranuar kërkesën për marrjen e statusit të konsumatorit të privilegjuar me dëshmitë e kërkuara me Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2009 (UA) të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave.
2. Me qëllim të kompletimit të aplikacionit ZRrE disa herë ka kërkuar nga aplikuesi dëshmi shtesë.
3. Pas kompletimit të aplikacionit, ZRrE ka vlerësuar atë dhe ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me nenin 3 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2009 i cili nen në paragrafin 1 përcakton se “Çdo konsumator jo-familjarë i energjisë elektrike ka të drejtë të aplikojnë për marrjen e statusit të konsumatorit të privilegjuar...”.
4. ZRrE duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi dhe në Udhëzimin Administrativ nr. 04/2009 të MEM-it , ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

5. Kompania "Birra Peja" do ta mbajë Statusin e Konsumatorit të Privilegjuar për aq kohë sa nuk paraqitet ndonjëra nga konditat e përcaktuara me nenin 4 të Udhëzimit Administrative 04/2009 që kanë të bëjnë me revokimin e statusit të konsumatorit të privilegjuar.
6. Në rast se konsumatori i privilegjuar ("Birra Peja" sh.a) lidh marrëveshje për furnizim me energji elektrike me furnizuesin publik, atëherë ajo marrëveshje do të jetë objekt i shqyrtimit dhe aprovimit nga ZRrE.
7. Ky Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
8. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordit i ZRrE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRrE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura mund të iniciojnë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen elektronike, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar